



UNIVERSITETI I MITROVICËS 'ISA BOLETINI'

Programi mësimor i lëndës (Syllabusi)		
Fakulteti:	Fakulteti Ekonomik	
Programi/Departamenti:	Biznes dhe Menaxhment/Specializimi: Menaxhment dhe Ndërmarrësi	
Niveli:	Bachelor	
Kodi i lëndës:		
Lënda:	Rritja dhe Ndërkombëtarizimi i NVM-ve	
Statusi i lëndës:		Zgjedhore
Semestri:		Veror
Fondi i orëve:	2+1	Sipas programit të aprovuar
ECTS:	4	Sipas programit të aprovuar
Orari/Salla		
Viti akademik:	Viti i tretë, Semestri i VI	
Mësimdhënës/e:	Prof. Ass. Dr. Filloreta Kunoviku Demiri	
Asistent/e:		
Kontaktet:	Mësimdhënës/e	Asistent/e
E-mail:	filloreta.demiri@umib.net	
Telefon:	+ 383 (0) 45 701 789	

PERMB AJTJE

Në ekonominë e sotme përballemi me sfidat e shumta të rritjes dhe ndërkombëtarizimit të bizneseve. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) janë lojtarë të rëndësishëm në shumicën e ekonomive anembanë botës dhe falë përshpejtimit të proceseve të globalizimit, një numër rekord NVM-sh kanë filluar të përfitojnë nga kushtet e reja mjedisore që paraqesin mundësi për rritje ndërkombëtare.

Globalizimi paraqet sfida të reja konkurruese, duke ofruar gjithashtu mundësi të reja të cilat po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për konkurrencën e ndërmarrjeve të të gjitha madhësive. Suksesi në arenën globale kërkon mendësi që mund të hartojnë strategji që ndërthurin aftësitë dhe përvojat e firmave ndërmarrëse me kompanitë e mëdha ndërkombëtare. Kursi fillon duke diskutuar karakteristikat specifike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve) duke i kushtuar vëmendje të veçantë rritjes, rëndësisë dhe kontributit ekonomik të tyre në ekonominë në mbarë botën, e ndjekur nga një ekzaminim i avantazheve të tyre konkurruese. Kursi do të përshkruajë lloje të ndryshme të NVM-ve, duke përfshirë por pa u kufizuar në mikro-bizneset, startup-et, firmat familjare, etj. Më pas, ne do të diskutojmë mënyrat dhe arsyet e ndërkombëtarizimit të NVM-ve.

Gjithashtu, do të diskutohen teoritë e biznesit ndërkombëtar, duke u fokusuar në NVM-të dhe mënyrat se si ato marrin vendime strategjike në një mjedis biznesi global gjithnjë e më të komplikuar.

QËLLIM I	Ky kurs synon të ofrojë një bazë gjithëpërfshirëse për të analizuar dhe kuptuar rritjen dhe ndërkombëtarizimin bizneseve. Qëllimi i këtij kursi është t'u ofrojë studentëve njohuri rreth proceseve të rritjes dhe ndërkombëtarizimit të bizneseve si dhe mundësive dhe sfidave të ndryshme me të cilat përballen kompanitë gjatë këtyre proceseve. Ky kurs synon të ndihmojë studentët të kuptojnë këtë dinamikë dhe se si ajo ndikon në NVM-të.	
ARRITSHMËRI A	☐ Me kompletimin e lëndës, studentët do të jetë në gjendje të: 1. <u>Përcaktojnë</u>, shpjegojnë dhe krahasojnë konceptet, perspektivat dhe teoritë përkatëse brenda fushës së hyrjes në tregun e huaj dhe proceseve të vazhdueshme të ndërkombëtarizimit të firmave; 2. <u>Analizojnë</u> në mënyrë kritike problemet komplekse që lidhen me rritjen dhe ndërkombëtarizimin e firmave dhe zgjerimin ndërkombëtar; 3. <u>Diskutojnë</u>, reflektojnë në mënyrë kritike dhe vlerësojnë teoritë dhe perspektivat brenda fushës së ndërkombëtarizimit; 4. <u>Argumentojnë</u> dhe shpjegojnë tendencat dhe sfidat bashkëkohore në lidhje me ndërkombëtarizimin e firmave dhe bizneseve; 5. <u>Zhvillojnë</u> njohuri, kompetenca dhe aftësi se si të analizojnë dhe trajtojnë problemet praktike dhe relevante me të cilat mund të përballen menaxherët gjatë krijimit të operacioneve të biznesit në vende të tjera; 6. <u>Krijojnë</u> zgjidhje të problemeve me gojë dhe me shkrim.	
PROGRAMI	Javët	Tema
	Java - I	Përmbajtja dhe njohja me lëndën (Syllabusi)
	Java - II	Definimi dhe Rëndësia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme
	Java - III	Llojet e NVM-ve
	Java - IV	Barrierat për zhvillimin e NVM-ve
	Java - V	Rritja e NVM-ve
	Java - VI	Avantazhi Konkurrues i NVM-ve dhe Determinantët e Ndërkombëtarizimit të NVM-ve
	Java - VII	Kollokviumi i Parë
	Java - VIII	Bazat Teorike të Ndërkombëtarizimit të Firmës
	Java - IX	Qasjet klasike drejt Ndërkombëtarizimit të NVM-ve
	Java - X	Proceset e Ndërkombëtarizimit të NVM-ve: Konteksti dhe dallimet rajonale
	Java - XI	Strategjitë e Ndërkombëtarizimit për NVM-të: Bukuria e Born Globals
	Java - XII	Udhëheqja e shekullit të 21-të: Kompetencat e NVM-ve
	Java - XIII	Avantazhet Konkurruese të NVM-ve Ndërkombëtare

	Java - XIV	Ligjëratë përmbledhëse dhe Prezentimi i punimeve seminarike, eseve, punës në teren, punës në grupe, etj.
	<u>Java - XV</u>	Kollokviumi i Dytë
LITERATURA	Literatura themelore: 1. Noemie Dominguez – Risa, <i>SMEs Internationalization Strategies</i>, Wiley, 2018. 2. Ilan Bijaoui, <i>SMEs in an Era of Globalization: International business and Market Strategies</i>, Palgrave Macmillan 2017. 3. Margi Levy and Philip Powell, <i>Strategies for Growth in SMEs</i>, 2005 Literaturë plotësuese: 1. Hamid Etemad and Richard Wright, <i>Globalization and Entrepreneurship</i>, 2003. 2. Helena Lenihan, Bernadete Andreosso-O’Callaghan and Mark Hart, <i>SMEs in a Globalized World</i>, 2010. 3. Noemie Dominguez and Ulrike Mayrhofer, <i>Key Success Factors of SME Internationalization</i>, 2018.	
METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJËS	Në kuadër të këtij semestri janë të paraparë 15 Javë me nga 2 orë ligjërata dhe 1 ushtrime (seminare dhe diskutime), si dhe dy kollokfiume të cilat mbahen brenda 15 ligjëratave të planifikuara (javën e 7 dhe 15). Studimet e rastit dhe detyrat e shtëpisë jipen pas çdo ligjërata për studentët me qëllim që studentët të studiojnë dhe hulumtojnë në kohën e studimeve vetanake. Rezultatet nga aktivitetet e tilla paraqiten dhe diskutohen në javën vijuese. Studentët inkurajohen për të ndjekur zhvillimet aktuale ekonomike duke lexuar artikuj, gazeta ekonomike si dhe materiale të tjera relevante. Ata mund të identifikojnë çështjet/temat e radhës për diskutim nga lexime të tilla. Esetë e përgatitura nga studentët gjithashtu do të diskutohen si dhe inkurajohen prezantimet individuale dhe grupe.	

	Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)			
	Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
	Ligjërata	2	15	30
	Ushtrime	1	15	15
	Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	1	15	15
	Kolokiume /seminare	2	2	4
	Detyra të pavarura			
	Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	6	24
	Përgatitja përfundimtare për provim	2	4	8
	Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final	/	/	/
	Projektet, prezantimet, etj	1	8	8
	Totali			104 orë= 4 ECTS
VLERËS IMI	Metodat e vlerësimit <u>Vlerësimi në %</u> Testi i –I-rë, me shkrim25% Testi i – II-të, me shkrim25% Aktiviteti në klasë10% Punime seminarike.....10% Povimi final30% Shkallët e notave : 50-me pak – nota 5 (pesë) 51-60 % - nota 6 (gjashtë) 61-70 % - nota 7 (shtatë) 71-80 % - nota 8 (tetë) 81-90 % - nota (nëntë) 91-100 % - nota (dhjetë)			
POLITI KAT AKADE MIKE	Studentët pritet të marrin pjesë rregullisht në ligjërata. Ata pritet gjithashtu të jenë aktiv në ligjërata, seminare dhe diskutimeve individuale dhe grupore. Profesori është në dispozicion për konsultime individuale. Studentët janë të detyruar për të lexuar literaturë para çdo ligjërata. Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera të universitetit. Kodi e mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit.			

Mitrovicë

Bartës/e i/e lëndës:

Prof. Ass. Dr. Filloreta KUNOVIKU DEMIRI

19/12/2021

(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)

